



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-26201-6503 dt. 18/02 2026

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Burim Bujupi, më datë: 26.02.2026 (e enjete) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal i dt. 30.01.2026
2. Plani i punës së KKS-së për vitin 2026.
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Lokal të veprimit në mjedis 2025-2029.
4. Propozim vendim për miratimin e Planit Lokal për strategji të cilësisë së ajrit, Komuna e Drenasit 2025-2029.
5. Miratimi i raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
6. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.
7. Propozim vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik-juridik (deri 99 vite)
8. Të ndryshme

Drenas, 18.02.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-6504 dt. 18/02 2026

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 30.01.2026, e cila filloi në ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 27 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Burim Bujupi, Ekrem Elshani, Naim Gjeli, Anjeza Kurtaj, Selman Qallapeku, Valdet Curri, Qendresë Xhema, Gani Krasniqi, Edon Nishori, Erblinë Morina, Fitore Morina-Hoxha, Driton Ajazi, Arigon Sinani, Jahir Hajdari, Zeqir Hasi, Mërgim Pirraku, Muhamet Xhemajlaj, Artian Krasniqi, Tringa Bujupi, Pajtime Berisha, Luljeta Elshani, Egzona Tërdevci, Xhavit Drenori, Arbër Halilaj, Mehedin Salihu, Egzon Qorri, Liman Krasniqi.

Të pranishëm ishin edhe : Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala, nënkryetar, përfaqësuesit e OSEB-së, KFOR-it, zyra e kryetarit dhe media.

Mbledhja do të ketë

Rend dite:

1. Mehedin Salihu emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas nga subjekti politik " Për Drenas e Kosovë", duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Salih Dvoranin;
2. Procesverbali i mbledhjes inauguruese të Kuvendit Komunal i dt. 10.12.2025;
3. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme i Kuvendit Komunal i dt. 17.12.2025;
4. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal i dt. 24.12.2025;
5. Propozim - vendim për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 02 nr. 020/04-53198 të dt. 18.12.2025;
6. Propozim- vendim për plotësim-ndryshimin e Vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për kompaninë rajonale të mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Drenas;
7. Propozim - vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit komunal të aksionareve për NPL "Stacioni i Autobusëve Sh.A.A. Glllogoc;
8. Propozim - vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik-juridik për (99 vjet);
9. Raport i punës së Kryetarit dhe drejtorive të Komunës së Drenasit për vitin 2025;
10. Raporti financiar janar-dhjetor 2025;
11. Raport vjetor i punës së njësisë së auditimit të brendshëm të Komunës së Drenasit si dhe Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve për vitin 2025;
12. Raport i përgjithshëm mbi gjendjen faktike lidhur me përmbushjen e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim;
13. Njoftim lidhur me vërshimet në territorin e Komunës së Drenasit;
14. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi seancën duke prezantuar pikat e rendit të ditës për shqyrtim. Pas miratimit të procedurave fillestare, ai ia kaloi fjalën asamblistes **Egzona Tërdevci**.

Egzona Tërdevci, faleminderit kryesues, unë propozoj që pika e tetë (8. Propozim-vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë-juridikë për 99 vjet), të hiqet si pikë e rendit të ditës. Sipas arsytimit ka shumë investitorë që i kanë kërkuar

këto prona, le t'i kemi ne si asamblistë ato kërkesat e këtyre investitorëve, të dimë kush po i kërkon, e mandej vendosim, a t'i japim apo jo në shfrytëzim.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ky është një propozim-vendim paraprak që e ka për obligim Kuvendi ta miratojë. Është edhe kërkesë e Ministrisë së Pushtetit Lokal për të paraqitur listën në ueb-faqe të Komunës. Janë disa procedura, siç është procedura me negociim apo procedura me thirrje publike. Kur procedojmë me thirrje publike, aplikojnë kompani të cilat duan të kenë një pronë publike në shfrytëzim për 99 vjet, pastaj janë komisionet, pastaj vjen edhe një herë te ju, dhe ju jeni ata që vendosni ta jepni ose mos ta jepni pronën në shfrytëzim. Unë e kam dërguar në Kuvend si pikë të rendit të ditës për shkak se kjo është edhe pikë e cila vlerësohet në grantin e performancës. Të paktën nuk dua t'i humb qytetarit tri pikë pse ne nuk e kemi sjellë në Kuvend listën paraprake të pronave, askujt nuk i kemi dhënë, as nuk i japim prona me këtë listë.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, pasi që nuk pati diskutime të tjera, vërejtje apo sugjerime, hodhi në votim rendin e ditës ku të pranishëm ishin 27 anëtarë.
Për votuan 24, kundër 2, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës: 1. Mehedin Salihu emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas nga subjekti politik "Për Drenas e Kosovë", duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Salih Dvorani. Sipas procedurës, kryesuesi lexon betimin dhe z.Mehedin Salihu betohet.

Mehedin Salihu, "Betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat, dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Gllogoc), në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e tretë të rendit të ditës: 3. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal i dt. 17.12.2025. Diskutime, vërejtje apo sugjerime nuk pati.

Për votuan 26, kundër 0, abstenim 1.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e katërt të rendit të ditës: 4. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal i dt. 24.12.2025. Diskutime, vërejtje apo sugjerime nuk pati.

Për votuan 27, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e pestë: 5. Propozim-vendim për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 02 nr. 020/04-53198 të dt. 18.12.2025. Ligjshmëria e këtij

vendimi është kthyer negativ për shkak të mosrespektimit të kuotës gjinore. Këtë ndryshim presim ta bëjë grupi i PDK-së. Fjalën e merr Xhavit Drenori.

Xhavit Drenori, në si grup çështjet ligjore nuk i kontestojmë absolutisht, se a i takojnë grupit të PDK-së apo jo, prandaj si të vendosin ata për ne është në rregull dhe e votojmë "Për".

Zeqir Hasi, edhe ne e kemi parë ligjshmërinë e vendimit nga MAPL-ja. Atëherë, te grupi ynë kuvendar i PDK-së, pas shumë diskutimesh mes nesh nuk kemi rënë në dakord, kështu që ne shkojmë me tre emra, një femër dhe dy meshkuj. Kërkoj mirëkuptim nga të gjithë asamblistët që të shkojmë në votim për Arigon Sinanin dhe Zeqir Hasin.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, kërkesa e MAPL-së ka qenë që të plotësohet kuota gjinore, të largohet njëri nga gjinia mashkullore dhe të shtohet një nga gjinia femërore. Për korrektësi shkojmë në pauzë për 10 minuta.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, të nderuar, vazhdojmë ku mbetëm. Të propozuarit ishin Arigon Sinani, Zeqir Hasi dhe Pajtime Berisha.

Zeqir Hasi, në si grup kuvendar i PDK-së u dakorduam që ashtu si të vendosë asambleja, jemi në rregull dhe vazhdojmë me votim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, vazhdojmë me votim të fshehtë për anëtarin e KPF-së, të cilët janë Arigon Sinani dhe Zeqir Hasi. Pas përfundimit të votimit fjalën e merr Egzona Tërdevci, kryetare e komisionit e cila konfirmoi që në votim morën pjesë 27 anëtarë. Të gjitha votat ishin të vlefshme, 16 vota janë për Arigon Sinanin dhe 11 vota për Zeqir Hasin. Rrjedhimisht, Arigon Sinani i bashkohet Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, të nderuar, tani Komiteti për Politikë dhe Financa do të përbëhet nga këta anëtarë:

1. Burim Bujupi - kryesues - PDKRLL,
2. Selman Qallapeku - anëtar PDKRLL,
3. Fitore Morina - anëtare PDKRLL,
4. Arigon Sinani - anëtar PDK,
5. Pajtime Berisha - anëtar PDK,
6. Egzona Tërdevci - anëtare VV,
7. Arbër Halilaj - anëtar BD.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës: 5. Propozim-vendim për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 02 nr. 020/04-53198, të dt. 18.12.2025. Për votua 27, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e gjashtë: 6. Propozim-vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit komunal të aksionarëve për kompaninë rajonale të mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Drenas. Sa herë që fillon mandati i ri, duhet të zgjidhen anëtarët e rinj të komisionit. Në këtë rast, kemi tre anëtarë, një nga ekzekutivi dhe dy anëtarë nga grupet më të mëdha kuvendare.

Xhavit Drenori, vjen një dokument si ky propozim-vendim dhe nuk ka asnjë dokument sqarues se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e këtij anëtar të Kuvendit. Unë kërkoj që të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe të na sjellin një sqarim për detyrat e përgjegjësitë e komisionit, si dhe një paragraf ku obligohet ky komision, ku janë anëtarët e Kuvendit, që për çdo gjashtë muaj të raportojnë para Kuvendit Komunal.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, faleminderit, e keni rregulloren, preambula (neni 2) i përcakton detyrat se çfarë duhet të bëjnë. Komisioni formohet me ligj, janë dy anëtarë nga Kuvendi (nga grupet më të mëdha kuvendare) dhe një nga ekzekutivi. Raportin mund ta kërkon pas gjashtë muajsh se çfarë kanë bërë.

Gani Krasniqi, (shefi i grupit PDKRLL), propozon **Erblinë Morinë**. **Zeqir Hasi** (shefi i grupit PDK), propozon **Mërgim Pirrakun**. Nga ekzekutivi, Kryetari i Komunës, **Ramiz Lladrovci**, propozon nënkryetarin **Arben Shala**. *Pra, ky komision përbëhet nga: Erblinë Morina, Mërgim Pirraku dhe Arben Shala.*

Mërgim Pirraku, vetëm desha t'i përgjigjem z.Drenorit se çfarë detyrash ka aksionari nga Kuvendi, sepse kjo është në bazë të ligjit. Nuk vlen vetëm për KRM "Pastrimi", por për të gjitha kompanitë që janë publike e të pavarura. Ato janë të rregulluara me ligj dhe çdo gjë që është e rregulluar me ligj nuk ka nevojë të sillt këtu për t'u shpjeguar apo përsëritur. Çdo kompani ka drejtorin e përgjithshëm, bordin dhe këshillin e aksionarëve. Këshilli i aksionarëve nga Kuvendi ka shumë role, ku ndër to janë monitorimi, këshillimi dhe votimi i buxheteve.

Xhavit Drenori, faleminderit kryesues dhe kolegut për reagimin. Atje ku kërkohet të dërgoj votën time për të votuar dikë si anëtar komisioni, unë kam të drejtë të kërkoj raport. Vetëm do ta pyesja kolegun, më vjen marre (tani e kuptova) që paska qenë edhe në katërvjeçarin e kaluar në atë bord, ndërkohë që mbeturinat na kanë mbuluar. Të kisha qenë si ti, do të thosha që s'kam mundur të bëj asgjë dhe nuk do të shkoja më aty. Je profesor më vjen marre edhe mua, por duhet të vijë marre edhe ty, katër vjet në atë

bord, mbeturinat na mbuluan dhe t'i thua "pse anëtari i Kuvendit kërkon raport nga anëtari i Kuvendit". Kjo është pak e tepërt.

Mërgim Pirraku, së pari ose ka problem me memorien që vetë ai ngriti një çështje krejt tjetër. Së pari kërkoi detyrat dhe përgjegjësitë e aksionarit tani thotë unë e kërkoja një raport, më fal po je shumë kontradiktor o zotëri ajo kompani ka probleme shumë të mdhaja për më shumë se 20 vjet dhe nuk mundesh me i rregulluar, ka shumë përmirësim në krahasim me vitet e kaluara.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, e hodhi në votim pikë e gjashtë të rendit të ditës 6. Propozim vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit komunal të aksionareve për kompaninë rajonale të mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Drenas. Për votua 22, kundër 0, abstenim 3.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e shtatë 7. Propozim vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit komunal të aksionareve për NPL "Stacioni i Autobusëve Sh.A.A Gillogoc.

Gani Krasniqi, shefi i grupit PDKRLL propozon **NaimXhelin**.
Zeqir Hasi, shefi i grupit PDK-së, propozon **Driton Ajazin**.

Kryetari i Komunës së Drenasit RamizLladrovci, unë kërkoi që kur propozojnë grupet kuvendare të respektojnë kuotën gjinore, sepse ne nga ekzekutivi e kemi **Granit Elshanin**. Në orën 13:07 minuta, kryetari lëvizë për një udhëtim zyrtar dhe në vend të tij raporton Ruzhdi Lestrani, faleminderit për mirëkuptim.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, kërkoi mirëkuptim nga PDK, sepse tre anëtarët që i kemi janë të gjinisë mashkullore, sepse PDKRLL në komisionin e mëhershëm e propozoi një femër, nëse keni mundësi bëjeni një ndryshim.

Egzona Tërdevci, për mua nuk ka rëndësi se cilin votojmë. Pak më herët PDK-ja iu nënshtrua një procesi votimi. PDKRLL është në ekzekutiv dhe propozoi një burrë, le të propozojë PDKRLL një grua dhe kështu jeni në rregull me kuotën, pasi ju i keni dy propozime si PDKRLL (një nga ekzekutivi dhe një nga kuvendi).

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, zakonisht PDKRLL e ka respektuar kuotën gjinore, si në Komitetin për Politikë dhe Financa, ashtu edhe në Komitetin për Komunitete dhe në KRM 'Pastrimi'. Ekzekutivi dhe Kuvendi janë organe të ndryshme.

Zeqir Hasi, cmri ynë është **Driton Ajazi** dhe ashtu mbetet. Ju takon juve ta plotësoni kuotën. **Gani Krasniqi**, shefi i grupit PDKRLL ky është propozimi ynë i vetëm **NaimXheli** si anëtar në këtë komision.

Mërgim Pirraku, PDKRLL është e njëjta parti si në ekzekutiv, ashtu edhe në kuvend, kështu që ju takon juve ta rregulloni këtë çështje. Propozoj të merrni 10 minuta pauzë për ta zgjidhur këtë çështje.

Zeqir Hasi, PDK propozoi **Tringa Bujupin** si anëtarë të këtij komisioni.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, konstatoi se me këtë propozim, anëtarët e komisionit të ndërmarrjes publike **NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.** janë:

1. **Naim Xheli** – Anëtar i Kuvendit,
2. **Tringa Bujupi** – Anëtare e Kuvendit,
3. **Granit Elshani** – Anëtar nga Ekzekutivi.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e tetë të rendit të ditës: 8. Propozim-vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik-juridik (për 99 vjet).

Driton Ajazi, pasi përshëndeti të pranishmit, tha së është e çuditshme që në seancën e parë për vitin 2026, na vjen një pikë që është më kontradiktoria për momentin. Do të ishte mirë të kishim një pikë të rendit të ditës të propozuar për strategjinë se si të dalim nga vërshimet që po na kaplojnë çdo vit, apo ndonjë propozim për urën që lidh fshatin Shtrubullova. Çdo ditë qytetarët e atyre dy fshatrave janë të bllokuar dhe ballafaqohen me vështirësi, duke bërë kilometra rrugë për të ardhur në Drenas, ndërsa Kryetari e ka me ngut dhënien në shfrytëzim të pronave komunale për 99 vjet. Për ne, si grup kuvendar i PDK-së, kjo është e papranueshme. Thëksoj se për këtë pikë nevojitet një diskutim dhe një analizë më e thellë, sepse nuk jemi këtu për të ndarë borxhet e fushatës zgjedhore që ai ka premtuar.

Ne jemi këtu për t'u dhënë llogari qytetarëve dhe jemi për rritjen e vlerës së pronës komunale, por kjo duhet të bëhet në mënyrë transparente, të përgjegjshme dhe me një plan për zhvillim ekonomik. Pronat nuk duhet të jepen ashtu siç është paraparë në të kaluarën — duke ua dhënë 'dostave e jaraneve' që ata të fitojnë në kurriz të pronës së qytetarëve.

Prona është çështje e ndjeshme, ajo u përket qytetarëve dhe duhet t'u shërbejë të gjithëve.

Prandaj, në emër të grupit të asamblistëve të PDK-së, jemi kundër kësaj pike.

Nëse ka investitorë që duan të investojnë në Komunën e Drenasit, ata le të drejtohen pranë Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik. Drejtoria duhet ta sjellë kërkesën në Kuvendin Komunal, ne ta analizojmë planin dhe sigurisht që do të jemi pro dhënies së pronave që nuk i duhen qytetarëve ose janë të pashfrytëzueshme, me qëllim që t'ia rritim vlerën pronës komunale, të punësojmë njerëz dhe të zhvillojmë ekonominë e Drenasit. Por jo në këtë formë, pa asnjë sqarim, të kalojmë listën e pronave.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, kërkoi sqarim nga Driton Ajazi nëse po flet në emër të grupit të PDK-së apo në emrin e tij personal. **Driton Ajazi** thëksoi: Po flas në emrin tim personal.

Egzona Tërdevci, faleminderit kryesues. Përsëritet për të gjithë! Edhe mua po më vjen shumë keq që kryetari u deshtë të lëvizë për këtë pikë, sepse realisht ballafaqimi do të duhej të bëhej me të, meqenëse ai e ka dhënë propozimin. Unë po e filloj diskutimin për këtë temë duke lexuar nenin 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës publike të Komunës së Drenasit. Në këtë rast, neni 14, pika për propozimin e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, thotë. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës për miratim paraprak pronën e paluajtshme të Komunës për dhënien në shfrytëzim.

Ju lutem, a mundeni t'i sqaroni arsyet dhe interesin publik për dhënien në shfrytëzim të 27 pronave publike, sepse nga ai arsyetim shabllon që paraqitni sa herë që doni të jepni prona, për besë, nuk kuptohen as arsyet e as interesi i vërtetë publik.

Për ne, LVV-në, është problematike dhënia e secilës prej këtyre pronave, por unë dua të ndalem te disa në veçanti, siç është parcela **13-0 në Gillobar**. Nëse e shihni në listën e pronave të veçanta, por edhe në Gjeoportali, shihet se kjo pronë është parking i pishave. Pra, a mundeni të shpjegoni cila është logjika që t'u jepet në shfrytëzim personave fizikë e juridikë për 99 vjet parkingu të parku i vetëm që kanë qytetarët e Drenasit.

Ngastra kadastrale **2652-4 në Arllat** bllokoi rrugën 'Hel Bujupi' që të dërgon të disa shtëpi në Arllat. Cila është logjika këtu, Komuna në vend që t'ua lehtësojë jetën qytetarëve, ua bllokoi rrugën atyre. Ngastra **126-2**, që është ngjitur me parcelën ku janë zjarrfikësit, kjo parcelë do të duhej të lihej e lirë që në të ardhmen, kur të rriten kapacitetet, të mund të shfrytëzohej nga zjarrfikësit, e jo t'i jepet dikujt në shfrytëzim për 99 vjet.

Po ashtu, cila pjesë konkretisht e ngastrës **716-2 në Korroticë të Poshtme** do të jepet, sepse në atë ngastër ka rrugë që bllokohen nëse jepet. E kam të qartë që nuk do të jepet e gjithë ngastra, por nëse mundeni të na shpjegoni saktësisht cila pjesë do të jepet.

Gjithashtu, jam shumë kureshtarë të di pse këtë radhë nuk janë përfshirë tri pronat e famshme, prona **1032-2** (parcela ku është Komuna e vjetër), prona **743-30** (ku janë shpronësuar shtëpitë drejtësisht) si dhe prona **768-1** (ku ka qenë çerdhja e vetme publike). Në fakt, kam një hipotezë për këtë çështje. Kryetari herën e kaluar ka gabuar duke i futur në listë për miratim të vendimit paraprak, pastaj e ka kuptuar që ato prona që kalojnë me miratim paraprak nuk mund të jepen me negociim. Besoj se kjo është arsyeja, por do të kisha dashur të dëgjoja përgjigjen prej jush, pasi besoj se ju ka udhëzuar kryetari.

Jemi dëshmitarë se sa është manipuluar me pronën publike gjatë mandateve të Ramiz Lladrovci, me premtime për shumë vende punë e për të hyra të mëdha komunale. Nëse i shikojmë të hyrat nga raportet financiare, ato janë vlera të papërfillshme në këtë Kuvend. Përveç një raportimi të thatë dhe formal të cilin do ta kemi si pikë edhe sot, asnjëherë nuk është raportuar si duhet për pronat që aktualisht janë në shfrytëzim për 99 vjet. A i kanë realizuar vërtetë investimet kompanitë dhe personat që kanë marrë në shfrytëzim pronat e komunës tonë. A kanë ndikuar ato në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe në rritjen e punësimit në Drenas. Investimet e premtuar në Drenas, apo vetëm ua kanë shtuar fitimet disave.

Ne, si VV, e kemi kundërshtuar dhe do të vazhdojmë ta kundërshtojmë dhënien e pronave për 99 vjet sa herë që nuk bëhet fjalë për interes publik, sepse të gjithë jeni dëshmitarë që, kur ka qenë në pyetje interesi publik, ne i kemi votuar gjithmonë pronat. Ne nuk kemi qenë asnjëherë dhe

nuk jemi kundër zhvillimit ekonomik të komunës, por dhënia e 27 pronave publike për 99 vjet, nuk i kontribuon këtij zhvillimi. Sidomos pas asaj që kemi dëgjuar për mënyrën se si kryetari e ka trajtuar pronën publike. Të freskëta i kemi kujtimet nga diskutimet milionëshe, ku një kryetar që thirret në ligj, i ka lejuar vetes të flasë edhe për mbindërtime, që të gjithë e dimë se janë të jashtëligjshme.

Edon Nishori, përshëndetje për të gjithë. Deshta t'i replikoj Dritonit: sa i përket Izraelit, ai nuk është i rrethuar me ujë; në aspektin gjeografik njohuritë tuaja lënë shumë për të dëshiruar. Pika e dytë: kryetari tregoi që është rrugës për në Tiranë. Ai e tha këtë haptas, ai nuk ikën, ashtu siç nuk u ka ikur asnjëherë sfidave. Pika e tretë, u ndalë të vërshimet, kur është pika tetë për pronat e në fakt pikën e 13, ne e kemi për vërshimet që kemi me debat. Pika e katërt, kur dalin të pronat, po kritikojnë dhe po ia humbin vlerën Kuvendit. Në fund të fundit, është Kuvendi ai që do të japë votën finale për çfarëdo prone që jepet, qoftë për persona fizikë apo juridikë. Prandaj, nëse ka diçka që është e dëmshme, ne jemi këtu dhe nuk e lejojmë. Sot është vetëm hapja e procedurës, pastaj ka etapa të tjera. Ky është mendimi im, faleminderit.

Driton Ajazi, nuk e di nëse Edoni është asamblist apo avokat i kryetarit. Sa i përket Izraelit, kam lexuar në faqen e komunës që kryetari do të ketë shumë takime, e thashë në atë aspekt, për të parë se a ka marrë ndonjë praktikë të mirë. Izraeli është një ndër shtetet më të zhvilluara dhe të marrësh praktika prej këtij shteti nuk ka asgjë të keqe.

E para, e dyta ne të gjithë e dimë se si janë dhënë pronat dhe si po insistohet të jepen përsëri. Zotëri, ne jemi këtu për të dhënë llogari para qytetarëve. Unë nuk i jap llogari personale as kryetarit dhe as askujt. Mendoj që çdo gjë që diskutojmë duhet të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve dhe jo personale, ashtu siç po tingëllon të ti. Mendoj se më jetike për qytetarët e komunës tonë është të përgatisim një platformë së si t'i evitojmë vërshimet. Kjo është jetike. A i keni parë shiritat të ura e Shtrubulloves. Ne jemi këtu për t'ua lehtësuar jetën qytetarëve, jo me ja trashë biznesin askujt.

Çështja e pronave është shumë e ndjeshme, nuk mund ta kalosh ashtu vetëm hajt se po e kalojmë një listë. Siç tha edhe kolegja Egzona, le të na paraqesin një analizë të thellë, nëse dhënia e këtyre pronave krijon vende të reja punë dhe zhvillim ekonomik, atëherë edhe ne jemi të pajtimit.

Arbër Halilaj, sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi Komunal është ai që i jep pronat në shfrytëzim, domethënë ne nuk i ikim përgjegjësisë që kemi. Në bazë të këtij ligji, në periudhën e qeverisjes së Isa Mustafës, kur komunat janë ankuar që nuk kanë mundësi të japin prona publike për projekte zhvillimore, është aprovuar versioni i parë i Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me qëllimin e mirë që komuna të ketë zhvillim ekonomik dhe realizim të projekteve në interes të përgjithshëm të qytetarëve.

Në përgjithësi, ky ligj ka shumë zbrazëtira dhe mbeten të paqarta disa nga paragrafët e tij, gjë që pastaj na shkakton edhe neve telashe për të zbatuar këtë përgjegjësi tonën për dhënien e pronave. Do të kisha cekur edhe nenin 6, pika 1.1.3. Në këtë propozim-vendim nuk e shoh (arsyetimin); është një arsyetim i cili është "copy-paste" i paragrafëve të ligjit, mirëpo këtu pika 1.1.3 thotë të ketë arsyeshmëri të interesit të përgjithshëm publik. Pavarësisht që ne edhe në fazat e tjera mund të debatojmë, të votojmë ose të mos e votojmë një pronë të caktuar, mendoj që prej fillimit duhet të jemi transparentë dhe të jemi në vijë me këto kërkesa ligjore.

Në vijim, neni 7 thotë që Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit, gjë që unë nuk e shoh të lista e propozuar në propozim-vendim. Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 7, thotë të specifikohen arsytet, qëllimet dhe kohëzgjatja. Pra, çdo kund ceket interesi publik dhe arsyeshmëria, andaj duhet të jemi në përputhje me kërkesat e Ligjit 06/L-092, i cili pasohet pastaj edhe nga Rregullorja (Qarkorja) 09/2020, ku përcaktohen më detajisht procedurat. Nëse e shohim këtë rregullore, kur kemi para vetes ofertat, neni 20 i cek kriteret në bazë të të cilave duhet të vlerësohen ofertat më të favorshme. Pika 1.1.2 thotë, numri i të punësuarve.

Nga kjo listë të propozim-vendimi, unë e kam problemin se si ndërtimet e larta janë me interes zhvillimor ose si gjenerojnë punësim, apo diçka tjetër në favor të komunës. Kështu që, unë edhe ashtu kam qenë kundër Hartës Zonale prej të cilës derivon ky propozim, dhe jam kundër që në këtë mënyrë të shkohet me votimin e kësaj pike pa një analizë të detajuar të çështjeve të cilat i ceka.

Xhavit Drenori, tha se pajtohem me ato çfarë thanë parafolësit dhe pajtohem plotësisht që kjo pikë duhet të votohet kundër, ky është pozicioni i imi personal. E para ne jemi të thirrur 27 anëtarë të Kuvendit këtu për me i mbrojt interesat e qytetarëve dhe në këtë aspekt është mirë të kemi kujdes. Unë jam i sigurt së edhe po të kishte fituar ndonjë subjekt tjetër politik, do t'i kishte sjellë pronat në Kuvend për t'i dhënë në shfrytëzim, sepse kjo është një mënyrë për të gjeneruar vende pune.

Njëjtë do të kishim bërë edhe ne, edhe ata, edhe secili, por e kemi një problem: ne nuk jemi mjaftueshëm të informuar. Pse nuk jemi të informuar, janë dy probleme, i pari, ekzekutivi ka sjellë raporte të ngushta, që për mua nuk janë të mjaftueshme dhe i dyti, ne nuk po bëjmë asnjë hap si anëtarë të Kuvendit që t'i sigurojmë vetë këto informacione.

Prandaj, jam sot para mikrofonit për dy gjëra. E para, ta lëmë ekzekutivin, ai i sjell raportet ashtu siç di dhe siç dëshiron, e ne nuk mund t'i imponojmë të sjellë raporte më të detajuara. Por, ne mund ta formojmë një komision brenda Kuvendit, sepse kemi një muaj kohë.

Nëse sot e rrëzojmë këtë propozim, brenda një muaji mund të kemi qasje në dokumentet publike në Komunë dhe në Ministrinë e Financave ku janë të evidentuara kompanitë. Shkojmë edhe në vendngjarje, e sjellim raportin këtu dhe e ballafaqojmë kryetarin dhe e pyesim, ku janë.

E keni dhënë pronën komunale me këtë kontratë, por kjo kontratë nuk po realizohet.

Ne e dimë që shumë prej tyre nuk realizohen dhe këtu dalim të ujërat që përmendi z. Ajazi.

Në fakt, dihet që pronat komunale në mënyrë të vazhdueshme u janë dhënë njerëzve që u kanë ndihmuar në zgjedhje. Kush më mirë së PDK-ja i di këto gjëra, sepse PDK-ja e ka mbjellë këtë dukuri në Drenas. E jani t'i formojmë komisionet komunale mbipartiake dhe mbigjinore, dalim dhe i ballafaqojmë në mbledhjen e radhës dhe u themi. Jo zotëri, sepse këto prona që i keni dhënë para katër viteve nuk janë askund në pika.

Është një çështje që mua më dhemb, pse duhet që prona të jepet për 99 vjet. A nuk po u hyjmë në hak fëmijëve tanë. Pse nuk e zvogëlojmë këtë afat në 20 vjet, por me mundësi vazhdimi. Nëse një subjekt afarist për 20 vjet nuk ka arritur ta zhvillojë biznesin, atij nuk i përtërihet kontrata, por i hiqet e drejta dhe i vazhdohet dikujt tjetër. Prandaj, unë mendoj se për këto dy pika nuk na ka faj as ekzekutivi e as dikush tjetër, por është pa gatishmëria jonë që edhe ne vetë të bëjmë diçka, sepse ne si anëtarë të Kuvendit kemi të drejtë të formojmë komisione.

Gani Krasniqi, përshëndetje për të gjithë. Ne patëm një takim me Kryetarin, i cili na informoi për takimet që ka pasur në një komunë të Izraelit, duke shkëmbyer shumë ide dhe iniciativa të mira për ta zhvilluar Drenasin në formën më të mirë të mundshme. Ju kisha lutur të gjithëve, mos i përdorni fjalët "argat i Kryetarit" apo "punëtor i Kryetarit", sepse këtu të gjithë jemi të barabartë. Respekt për të gjithë.

Driton Ajazi: Me gjithë respektin për mësuesin Gani, uroj që ato praktika t'i implementojmë. Të jesh i bindur që çdo praktikë të mirë, e cila e përmirëson jetën e qytetarëve të Drenasit, unë do ta votoj hapazi.

Liman Krasniqi, përshëndetje për të gjithë. Pronat komunale duhet të jepen për interes publik. Interesi publik përcakton në aspektin urban së ku ato prona duhet të jepen në dobi të funksionimit të vendbanimeve dhe në të mirën e të gjithë qytetarëve. Dëshiroj t'i sqaroj disa prej pronave, siç është ajo afër Qendrës së Mjekësisë Familjare në Komoran, e cila më parë ka qenë e destinuar për park të vendbanimit. Në këtë park gravitojnë më tepër se 10,000 banorë. Pronat në sipërfaqet e lira të një vendbanimi i japim kishe për interes publik, por realisht jemi duke i votuar për interes privat.

Kompanitë që merren me biznes, si për shembull ato tregtare apo çfarëdo qofshin, nuk përbëjnë interes publik. Interes publik janë kompanitë publike, siç janë çerdhet dhe shkollat. Nuk mundemi ne që në mes të qendrës të japim një pronë prej 30 ari, të destinuar për interes publik, një biznesi privat. Çfarë dobie ka popullata. Ne të gjithë po i kritikojmë disa qytete për ngulfatje të vendbanimeve dhe të hapësirave gjelbëruese brenda qendrës.

Prona tjetër është të hidrostationi i pompave, ku sipas parashikimeve të kaluara dhe të tanishme - të cilat nuk është mirë të ndryshohen — duhet të zgjerohet stacioni i pompave. Ai stacion ka qenë i paraparë për t'i furnizuar të gjitha ato fshatra, prej Zabelit të Ulët e deri të fshatrat e fundit. Në aspektin profesional, ta përkrahësh destinimin e një sipërfaqeje ku ndodhet shkolla fillore, që ajo të jepet për biznese të tjera për shërbim tregtar, komercial e ndërtimor, për mua si profesionist është turp. Nuk e di se sa është marrë parasysh Plani Zhvillimor dhe ai Urban.

Është menduar që oborri i Komunës të jepet në shfrytëzim për ndërtesa banimi.

Oborri i Komunës ka qenë i planifikuar për një muze, bibliotekë dhe sallë kulture, këto janë interes publik, nuk janë ndërtesa banimi. Pastaj, të stacioni i autobusëve, pavarësisht gabimeve në aspektin e planifikimit hapësinor, Kosovës i mungon një planifikim i vijave të komunikacionit, sepse nuk është në rregull që rruga regjionale me katër korsi të kalojë përmes qendrës së vendbanimit. Kush ka qenë ai menaxher i planit zhvillimor që ka lejuar ndërrimin e Planit Urban dhe Rregullues së kaluar, kur blloku urban ka qenë shumë mirë i destinuar edhe në të kaluarën për objekte arsimore, prej shkollës deri të çerdhja e fëmijëve. Si përfundim i të gjithë kësaj, kisha kërkuar që të mos sillen prona të cilat janë për interes publik dhe interes të objekteve publike për t'i tjetërsuar dhe për t'i dhënë për interes të kompanive private.

Çfarë arsyetimi do t'i japim Ministrisë së Infrastrukturës që po i zëmë sipërfaqet afër rrugës me objekte biznesi, ku zhvillohet shpejtësi prej 80 km deri në 120 km? Çfarë do t'u lëmë pasardhësve tanë, si anëtarë të Kuvendit apo si Drejtori e Urbanizmit dhe Planifikimit Urban.

Pjesa të varrezat e Drenasit e deri të Lumi Drenica ka qenë e paraparë si gjelbërim. Duke pasur parasysh që nuk ka pasur analiza për sasinë e ujit që vjen nga lumi i Verbica, që më pas të mund të parashikohet gjerësia e lumenjve, ajo pjesë është kthyer në tokë ndërtimore.

Është ngushtuar shtrati i lumit dhe është rritur niveli i vërshimeve në qendrën tregtare.

Pse? Ne në shkullin XXI, me përgatitjen profesionale që konsiderojmë se kemi, të degradojmë një sipërfaqe dhe një plan urbanistik.

Të marrim rastin e Komoranit të ura, vërshimet e ujit asnjëherë nuk kanë qenë të këtij niveli. Ne nuk mund t'i ndalim vërshimet, por duhet të marrim mësim. Pse kemi krijuar "fyte të ngushta" të ura e Drenasit dhe të ura e Komoranit? Sipërfaqja e cila i është dhënë kompanisë ETC ka qenë e destinuar për zgjerimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare, sot aty e kanë ngushtuar pjesën të ura dhe vërshimet nuk kanë pasur mundësi ta përcjellin atë sasi të ujit. Ekspertët të cilët i keni angazhuar për të bërë planin urbanistik nuk janë të fushës përkatëse. Cilin ekspert të komunikacionit e keni pasur për të ditur saktë se nga duhet të kalojë vija, për ta liruar qendrën prej komunikacionit të rëndë. Prandaj, ne duhet të kemi një komision profesional që t'i kontrollojë këto çështje, në mënyrë që të mos bëjmë degradim në aspektin urban dhe zhvillimor.

Xhavit Drenori, po i nderuar koleg. Unë isha ai që thashë. Po e bëjmë një komision, sepse nuk na ndalon askush ta bëjmë këtë punë. Do të kishim pasur informacione të jashtëzakonshme prej dorës së parë dhe do të kishim mundur të ballafaqoheshim me fakte. Mirëpo, anëtarët e Kuvendit, me disa përjashtime, i kushtojnë më shumë rëndësi pamjes se si po duken – a po dalin 'selfie seksi' në Kuvend apo jo.

Megjithatë, kështu nuk përfaqësohen qytetarët me fjalë boshe. Kur dalim para mikrofonit, duhet t'u themi. 'Zotëri, këto janë faktet'. Me ato fakte ne mundemi t'i dërgojmë lëndët edhe në prokurori, nuk do të kishte guxuar asnjë ekzekutiv, jo i kësaj Komune por asnjë tjetër, kur ta ballafaqonit me dokumente dhe jo me fjalë boshe para mikrofonit.

Mehedin Salihu, ju përshëndes të gjithëve. Dhënia e pronave në Drenas nuk është prioritet, kemi shumë gjëra që janë më prioritare dhe me ato gjëra duhet të merremi. Unë e kam një pyetje për drejtorin. Pse po i sillni 27 prona përnjëherë. Ky është fillimi i mandatit, ne nuk po e përfundojmë mandatin sot. Për të pasur një analizë më të shkurtër në Kuvend, duhet t'i sillni nga 2-3 prona, maksimumi 4. Kështu i analizojmë më mirë, ndërsa ju i sillni 'blanko', sikur të ishte fundi i mandatit tonë.

Naim Xheli, përshëndetje për të gjithë. Unë kisha thënë të përqendrohemi më shumë në pikat e rendit të ditës e të mos bëjmë debate si të ishim në fushatë. Mos t'i ofendojmë dhe mos t'i paragjykojmë shumë të tjerët, sepse Drenori e bëri këtë disa herë, duke thënë se ka shumë që hyjnë nëpër komisione e nuk dinë. Unë mendoj që këtu ka shumë djem dhe vajza të përgatitur dhe me energji.

Xhavit Drenori, unë kam të drejtë ta them atë që thashë, nuk je ai që e jep vulën së kush paragjykon.

Artian Krasniqi, të gjithë e pamë se si Kryetari i iniciativës doli nga seanca pikërisht për pikën që doli për pronat komunale. Të gjithë e dinë se, nëse Ramiz Lladrovi do të ishte i bindur që do t'i kalonte sot pronat, ai do të qëndronte këtu, prandaj të mos sillemi me hipokrizi. Prona komunale është çështje serioze dhe kërkon përballje, nuk kërkon shmangie.

Unë dua t'i falënderoj edhe një herë të gjithë bashkëqytetarët që ma kanë dhënë besimin, sepse, ashtu siç e kam kundërshtuar më 19 shtator 2024 si aktivist e si qytetar, tani kam mundësi që

këtë çështje ta votoj kundër dhe me mandat zyrtar ta kundërshtoj me votë. Qëndrimi im është i njëjtë dhe i pandryshueshëm: votë kundër dhënies së pronave publike. Faleminderit.

Mërgim Pirraku, po mundohem me folë shkurt, pajtohem plotësisht me Liman Krasniqin, jam kundër dhënies së pronave në qytetin e Drenasit dhe në Komoran. Unë e konsideroj, ne si Kuvend nuk jemi të gatshëm me i dhënë këto prona. Sigurisht që unë e respektoj secilin mendim të këtyre dhe dikush mundet me qenë i djathtë politikisht dhe me e përkrahë idenë për privatizim. Dikush mundet me qenë i majtë dhe me e ruajt shtetin, mirëpo unë e konsideroj që ne si Kuvend nuk jemi të gatshëm për dhënien e pronave dhe pajtohem me Drenorin që duhet me u bërë një komision i cili përbëhet prej anëtarëve të Kuvendit, ekzekutivit, prej drejtorisë përkatëse dhe prej ekspertëve që mundet me qenë të jashtëm dhe me bërë analiza shumë të detajuara dhe të thella dhe me ditë, kur të vijnë pronat këtu, cilat kemi interes me i dhënë e cilat jo.

Në qoftë se kjo shkon në votim, unë kisha propozuar që secili anëtar i Kuvendit me marrë fjalën, me e përmendë dhe me paraqitë votën e vet, sepse po fshihemi pas disa votave kështu 'blanko', edhe tani nuk po dihet as kush votoi, as kush nuk votoi. Edhe qytetarët le ta dinë kush i ka dhënë këto prona e kush jo. Sigurisht unë, si Mërgim, nuk jam kundër dhënies së pronave, mirëpo duhet me shkuar në mënyrë të rregullt, me komisione, për me qenë gjithçka në rregull.

Arben Shala, ju dëgjova të gjithëve, do të mundohem t'ju përgjigjem secilit. U fol për terr informativ, problemi është se, në qoftë se terrin ta bën dikush tjetër është diçka, por nëse t'i ia bën vetes, atëherë problemi është te individët në fjalë. U përmendën vërshimet, Izraeli, ku një pjesë e madhe është shkretëtirë, ju kisha këshilluar ta lexoni ligjin i cili e thotë qartë (Ligji nr. 06/L-092). Aty përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret për të cilat jepen pronat në shfrytëzim. Thotë: me negociim është 10% e shumës së buxhetit për investime kapitale. Do të thotë, në qoftë se në vitin e kaluar e kemi pasur 6 milionë, mënyra e vetme për me hy në negociim me Kryetarin do të jetë investimi në shumën 600 mijë euro. Nuk e besoj që dikush prej juve kishtë mundur me e kundërshtuar një investim 600 mijë euro, pa marrë parasysh se kush vjen, ndërsa pjesa tjetër shkon me thirrje publike. Por, cilado që të jetë mënyra, në fund të ju ka me ardhur.

Pyetët: Pse 99 vjet? Mund të jetë 20 vjet, 30 deri në 99 vjet, varësisht sa ka interes biznesi. U përmendën 'dostat' që në zgjedhjet e kaluara e kanë përkrahur DD-në që e kemi këtu. Pyetët pse në seancën e parë? Mercedesi i ka 4000 vende pune në Maqedoni e jo këtu. E në qoftë se Mercedesi don me investu për 1500 vende pune, a mundemi ne me dhënë pronë në shfrytëzim? Jo, nuk mundemi, se e kemi kaluar listën paraprake.

Tani, cilat janë arsyt? Arsyt janë se çdo ditë po dëmtohet prona publike, po ka uzurpime dhe po i bie vlera e saj. Obligim i joni është me e sjellë këtu listën, e ju e kaloni apo s'e kaloni, është në dorën tuaj. Me gjithë respektin për ju z. Liman Krasniqi, gjatë kohës sa ju keni qenë drejtor, e kemi këtë lagjen informale këtu, janë bërë ndërtime pa leje. Sa i përket ujërave, është Agjencia e Ujërave e cila merret me këtë punë, sa i përket rrugëve, është Ministria përkatëse. Ne çdo javë i dërgojmë kërkesë Ministrisë për mbylljen e gropave, ata as nuk përgjigjen. E përmende edhe Komunën e vjetër, e shoh që ke shumë paqartësi. Qëllimi ka qenë ndërtimi i lartë, por Komuna ka pasur pjesën e përfitimit të zyrave dhe objekteve, nuk ka qenë vetëm interes i dikujt, ka qenë interes i dyanshëm. Sot vijnë shumë organizata e shoqata, bëjnë kërkesa për zyra dhe s'kemi objekte me u dhënë.

Dua t'ju rikujtoj edhe një herë, jo kjo përbërje e Kuvendit, por ajo e kaluara i ka humbur kësaj Komune dhe këtyre qytetarëve 44 milionë euro, që ka qenë shuma e kërkuar për investime në

Komunën e Drenasit. Rasti më i njohur ka qenë një fermë shpezcësh në Likoshan, ku do të punësoheshin 400 gra. Prona në Komoran është punë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, por ne kemi bërë kërkesë vazhdimisht për ngritjen e një stacioni të zjarrfikësve aty.

Driton Ajazi, me gjithë respektin për nënkryetarin, të gjithë kemi qenë dëshmitarë se si është vepruar me pronat publike. I nderuar, e ke parë edhe t'i, edhe unë, edhe të gjithë qytetarët që Drenasi është mbushur me pompa derivatesh. Këto pompa derivatesh e dimë se kujt ia kanë dhënë.

Në mandatin e kaluar, kur ka aplikuar pikërisht për pompë Valdet Bujupi, atë e kanë detyruar ta ndërrojë projektin sepse nuk lejohej në vendbanim, për shkak të një distance të caktuar, ndërsa ia kanë dhënë të njëjtit për të njëjtën çështje. Sot është IP-ja aty. Asgjë nuk kam kundër, por të mendojmë edhe diçka tjetër, sepse e kemi obligim edhe për gjeneratat e ardhshme, nuk është etike t'i mbushim pronat publike me pompa derivatesh.

Liman Krasniqi, nuk ka mundësi që funksioni i objekteve publike me interes të veçantë të përzihet me objektet e banimit. Nuk mund të jetë një muze poshtë e lart banesa, apo zyrë poshtë e lart banesa, nëse Komuna i jep ato për subjekte juridike që kanë nevojë për zyra. Ndani funksionet në aspektin urban! Ekzistojnë sipërfaqet e destinuara si zona urbane – tani po ju thoni 'harta zonale'. Ju është dashur t'i sillnit pronat e ndara sipas qendrave, në qendër të Komoranit apo të Drenasit nuk mund të japim leje për ferma pulash. Sa i përket pronës së Ministrisë në Komoran, ato janë prona që i takojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme, konkretisht Policisë së Kosovës. Ne, si Komunë, nuk mund të menaxhojmë me ato prona. Në vitin 2009-2010, Ministria i ka kërkuar të gjitha pronat, jo vetëm në komunën tonë, por në mbarë Kosovën, dhe ne ia kemi dërguar të dhënat (pasi kam qenë drejtor edhe në Drejtorinë e Gjeodezisë).

Pra, nëse keni përfshirë një pronë të tillë, duhet ta hiqni, sepse nuk na takon neve. Ne duhet të japim sqarime sepse jemi këtu për të mirën e qytetarëve. Ju i keni sjellë pronat 'në një thes'. Kemi pasur planin e fizibilitetit për zonën industriale prej 106 hektarësh, por ju e keni shpërndarë në parcela, duke mos e lënë hapësirën për investitorë të kapaciteteve të mëdha. Kemi pasur edhe një donacion për trajtimin e ujërave me lëndë organike, të cilin unë vetë e kam sjellë në Komunën e Drenasit. E kemi shikuar lokacionin, kemi dalë të 'Guri i Plakës', është pajtuar Kryetari, por kemi lënë një ndërmjetësues dhe investitori polak është tërhequr. Ai ka pasur paraparë të investojë 3 deri në 6 milionë euro, por tha. Nuk mund të punoj me këta njerëz. Për të pasur një donator serioz, ne duhet t'i kemi të specifikuar lokacionet përkatëse në planet zhvillimore dhe urbane. Duhej të ishte pikëtuar funksioni i çdo lokacioni dhe destinimi i tij. Shpresoj të vijë një komision për trajtime profesionale dhe të kërkojë llogari nga drejtoritë përkatëse. Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Infrastrukturës, si dhe Drejtoria e Inspeksionit.

Egzona Tërdevci, nga nënkryetari u thanë shumë çështje, por unë realisht nuk mora përgjigje për adresimet e mia. Unë nuk thashë që jam kundër turizmit të pishat, por për mua është paradoksale që parkingu i pishave të jepet në shfrytëzim. Madje, nuk është vetëm parking, nëse e shihni në gjeoportali, sidomos ju që jeni të fushës, është edhe rruga. Çfarë logjike ka t'i jepet dikujt për 99 vjet rruga që të dërgon të pishat.

U përmend që legjislatura ka bllokuar dhënien e pronave, por jam shumë krenare që ua kemi ndaluar milionat për të cilët kemi dëgjuar publikisht. Po na akuzoni që kemi bllokuar, ndërkohë që ne kemi dhënë prona sa herë që ka qenë interesi publik, për energji të ripërtëritshme dhe për

policinë. Mirëpo, nuk mund të japim prona për t'ua trashur fitimet njerëzve që ia kanë mbyllur fushatat Kryetarit, sepse kemi përgjegjësi para atyre njerëzve që na kanë votuar. Para një muaji kemi bërë betimin se do të shërbejmë me nder dhe përgjegjësi, e nuk është shërbim me nder t'i përkrahësh persona të caktuar fizikë dhe juridikë.

Gjithashtu, e patët shumë të pavend dhe pa të drejtë çështjen e negocimit. Jemi dëshmitarë që vitin e kaluar, kur kanë hyrë tre prona që kanë qenë pjesë e vendimit paraprak, MAPL-ja ia ka kthyer kryetarit propozimin për negociim, sepse është e jashtëligjshme të negociosh për pronat që janë pjesë e vendimit paraprak. Po ashtu, më vjen shumë keq që secili prej jush që folët u krenuat me vizitën në Izrael. Për një Komunë që ka përjetuar kaq shumë nga gjenocidi dhe që ka kaq shumë të vrarë, një vizitë në një shtet gjenocidal, për besë, për mua është e papranueshme.

Xhavit Drenori, dy çështje shumë shkurt. E para (e thotë me shaka), nënkryetar "na i këpute të dyja këmbët" disave prej nesh që mendonim të kandidonim për kryetar pas katër vitesh. Çështja e dytë ka të bëjë me ngutën për pronat.

E thatë në mënyrë eksplicite se po dëmtohen pronat, po bëhen rrugë, po demoloohen e po hidhen mbeturina. A do të thotë kjo që ju, si ekzekutiv, kenë ngritur flamurin e bardhë dhe jeni dorëzuar. A nuk mund t'i ndalni këto dukuri e t'i mbronin pronat komunale, që është minimumi i punës suaj. Më duhet një sqarim për këtë çështje.

Ruzhdi Lestrani, përshëndetje për të gjithë. Vetëm një sqarim po e bëj. Këto janë prona të mundshme të cilat mund të lëshohen në shfrytëzim pas pranimi të ofertave, si dhe pas analizimit të këtyre pronave dhe ofertave nga komisioni, në përbërje të cilit do të jenë edhe anëtarët e Kuvendit. Pas këtyre analizave nga ky komision, këto do të vijojnë përsëri në Kuvend dhe Kuvendi do t'i shqyrtojë ofertat një nga një. Domethënë, të gjitha këto prona që janë në këtë listë, janë për verifikim paraprak ashtu siç e kërkon ligji. Pra, të gjitha këto prona janë të lira dhe nuk kanë sanksione juridike.

Ka edhe nga ato që janë të përgjithshme, ku do të lëshohet vetëm një pjesë e caktuar ose do të bëhet plotësim-ndryshim. Ndoshta, si në vitet e kaluara, asnjë nuk do të jepet në shfrytëzim, por kjo vetëm i jep mundësi Kuvendit të vazhdojë me ofertimin si për personat fizikë, ashtu edhe për ata juridikë.

Se a ka interes apo jo këtë e përcakton Plani Zhvillimor (i mirë apo i keq siç është), hartat zonale dhe Plani Rregullativ Urban. Unë nuk jam ai që mund të bëjë vlerësimin e tyre, pasi Plani Zhvillimor, hartat zonale dhe Plani Rregullativ kalojnë përmes ministrive të caktuara.

Asnjë pronë nuk jepet në shfrytëzim në qoftë se komisioni parashikon se nuk janë plotësuar kushtet për dhënie të tyre në shfrytëzim. Faleminderit.

Liman Krasniqi, nuk është arsye që të kërkojmë oferta për pronat të cilat nuk janë të destinuara për atë qëllim. Ne nuk mundemi që për një pronë, e cila është e destinuar për gjelbërim, park apo stacion pompash, të kërkojmë oferta prej një biznesi privat. Është dashur që pronat të ndahen në dy pjesë: kategoria e pronave që janë nëpër zona urbane e nëpër qendra dhe kategoria e pronave që janë në periferi.

Nëse ne duam t'i degradojmë këto sipërfaqe që kemi, atëherë një ditë do të marrim një vendim që shkatërron interesin e kësaj popullate për objekte publike. Ku doni të ndërtoni ju nesër apo pasnesër një sallë kulture ndër banesa. Nisur nga aspekti profesional, nuk ka mundësi që një bllok urban në katin përdhes të jetë teatër dhe lart të ketë banesa banimi. Vetëm krahasojeni se

çfarë i keni bërë 'Blokut 5', po e shfrytëzoj rastin ta përmend.

Një vërejtje paraprake për Drejtorinë e Urbanizmit. Ju e keni rrezikuar strukturën, nëse ndodh një tërmet që kalon 6 ballë, ai objekt do të rrënohet, sepse keni lëshuar leje për ndërrim destinimi dhe keni shkatërruar strukturën e objektit. Nuk mundemi ta shkatërrojmë edhe aspektin funksional të zonës së qendrës së Drenasit.

Ruzhdi Lestrani, i nderuar në bazë të këtij plani zhvillimor, çdo parcelë është e kategorizuar. Nëse nuk e keni planin, na dërgoni e-mailin tuaj dhe ne do t'ju dërgojmë linkun për qasje në Planin Zhvillimor dhe në Hartën Zonale. Tani keni mundësinë të bëni plotësim-ndryshimin.

Nënkryetar Arben Shala, u tha këtu që asamblistë të caktuar kanë bllokuar kalimin e listës së pronave. Unë i respektoj qëndrimet parimore, sepse secili individ ka të drejtën e mendimit, por ka pasur disa që kanë bërë pengesa me qëllim deri sa të vijmë në pushtet. Ju siguroj që kjo nuk do të zgjasë shumë. Zotëri Drenor, jo, nuk e kemi ngritur flamurin e bardhë dhe nuk kemi për ta ngritur as në të ardhmen. Ju iu referuat këtu një **'shteti gjenocidal'**, nuk besoj që kjo është pjesë e politikave lokale. Është mirë të përmbaheni, pasi janë ata persona që kanë bartur barrë gjatë intervenimit të NATO-s në Kosovë.

Mehedin Salihu, Nuk është fer të mos mundet të flasë njeriu. Ju po flisni për miliona investime e nuk po mundeni ta rregulloni një tel që të dëgjohet zëri. Si mund të besojë njeriu, kur nuk rregulloni dot një mjet komunikimi që as nuk ka kosto të lartë. Nuk është kosto e lartë, ju lutem.

Kryesues i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, zotëri Salihu, e keni edhe Ukë Krasniqin dëshmitar që e kam ngritur këtë çështje për rregullimin e mikrofonave. Kam kërkuar që edhe kamerat të jenë përcjellëse, në mënyrë që për cilindo që merr fjalën, të bëhet video-incizimi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e hodhi në votim pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë-juridikë (99 vite).

Për votuan: 9 Kundër: 15 Abstenime: 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e nëntë të rendit të ditës: 9. Raporti i punës së kryetarit dhe i drejtorive të Komunës së Drenasit për vitin 2025.

Egzona Tërdevci, unë e kam vetëm një pyetje të pjesa e prokurimit. Thuhet se është iniciuar shitja e dy aseteve, nëse mundeni, na tregoni së për cilat asete bëhet fjalë.

Laureta Thaqi Drejtoreshë e Administratës, meqenëse shefja e prokurimit nuk është e pranishme këtu, por si sektor prokurimi hyn në kuadër të administratës, po ju përgjigjem unë. Bëhet fjalë për asete të përdorura të Drejtorisë së Shëndetësisë, të cilat i nxjerrim me procedurë të prokurimit, përkatësisht përmes ankandit. Faleminderit.

Mërgim Pirraku, kam një propozim dhe pajtohem me z. Drenorin për formimin e komisioneve nga Kuvendi për monitorimin dhe ndihmën në punën e drejtorive. Propozoj që të hartojmë raporte më të shpeshta, përkatësisht çdo tre muaj, si dhe një raport përmbledhës në fund të çdo

viti, ku të raportohet për planet dhe pritshmëritë për vitet e ardhshme. Sigurisht që këto raporte bëhen, por duhen hartuar në mënyrë më të detajuar.

Për shembull, duke u ndërlidhur me Drejtorinë e Arsimit, z. Muhamet Gjoka duhet të na njoftojë para fillimit të mësimi në shtator se sa profesorë janë dhe sa vende mbeten të paplotësuara. Kemi pasur raste të përsëritura pothuajse çdo vit, kur mësimi ka filluar pa qenë plotësisht të gatshëm. Gjithashtu, kemi shumë raste kur punëtorët e arsimit vazhdojnë të mbajnë pozita si ushtrues detyre për afate të gjata pa kontrata të rregullta. Nuk më duket në rregull që të kemi probleme të përsëritura çdo vit, kjo vërejtje vlen edhe për drejtoritë e tjera.

Nënkryetari Arben Shala, ne e mirëpresim kontributin e komisioneve në këshillim. Sa i përket krijimit të tyre, dua t'i kujtoj z. Pirrakut se keni qenë edhe vitin e kaluar në komisionin për kompaninë 'Pastrimi', ku u kërkua të raportohet më herët, por ju nuk keni raportuar asnjëherë (të paktën një herë në gjashtë muaj e keni pasur si detyrim). Gjithashtu, në legjislaturën e kaluar ka qenë edhe një komision për dekorata kur morëm vendim për të shpallur 'Qytetar Nderi', ka pasë shumë kritika është krijuar komisioni nuk e di që ka hartuar ndonjë rregullore për këtë çështje.

Xhavit Drenori, kam një pyetje për Drejtorin e Arsimit lidhur me vitin 2025. Mbrëmë pashë një postim për shkollën e fshatit tim në Dobroshec, ku njoftohej se klasat po pajisen me klima.

U gëzova dhe më erdhi mirë, por sot u konsultova me disa ekspertë dhe më thanë që ky lloj ngrohjeje nuk është i shëndetshëm. Nëse mundeni të më ktheni një përgjigje, sepse nëse bëjmë ankesë në Ministrinë e Arsimit, ata mund të thonë që të mos përdoren klimat në këtë fazë, pasi mund të jenë të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.

Prandaj, ju lutem, merruni me këtë çështje deri në mbledhjen e ardhshme dhe na ktheni një përgjigje. Shëndeti i fëmijëve tanë është më i rëndësishëm se efienca e burimeve për ngrohje.

Nënkryetari Arben Shala, dua të theksoj se i kemi komitetet konsultative, do të ishte mirë që ato të jenë funksionale.

Egzona Tërdevci, të faqja 2 e raportit financiar ishte një gabim teknik. Të investimet kapitale thuhet se 2 milionë euro janë ekzekutuar për vendime gjyqësore. Nëse nuk e dini saktësisht, të paktën në vija të trashë, cilat projekte janë prekur nga këto pagesa. Aty shkruan shuma e shpenzuar për secilin projekt, por unë nuk e di a është realizuar projekti apo mjetet janë marrë nga përmbaruesi. Këtë mund ta kërkoj edhe me shkrim.

Kryesues i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, nëse nuk është dikush që të jep përgjigje tani, atëherë mbetet që ta marrësh përgjigjen me shkrim.

Driton Ajazi, faleminderit kryesues. E pashë tabelën të subvencionet janar–dhjetor 2025, si dhe krahasimet me vitet paraprake. Më bëri shumë përshtypje Zyra e Kryetarit, pasi që viti 2025 ka qenë vit zgjedhor, i ka rritur subvencionet për 300%. Në vitin 2023, Zyra e Kryetarit ka pasur 6,436 euro; në vitin 2024, 7,200 euro; ndërsa në vitin 2025, plot 26 mijë euro. Më bëri përshtypje kjo rritje."

Nënkryetari Arben Shala, me sa di unë, përqindja e subvencioneve përcaktohet nga shuma e buxhetit, në qoftë se çdo vit ka rritje të buxhetit, atëherë ka edhe rritje të subvencioneve. Ndërsa sa i përket përfituesve, shumica prej tyre, fatkeqësisht, kanë qenë me sëmundje malinje,

sepse përfituesit më të mëdhenj kanë qenë të sëmurët me kancer dhe nuk është shikuar në aspektin politik.

Kryesues i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e njëmbëdhjetë (11): Raporti vjetor i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit, si dhe plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve për vitin 2025.

Liman Krasniqi, kam një kërkesë që herëve të tjera të na jepni më tepër sqarime për vërejtjet dhe sugjerimet që u keni dhënë drejtorive të caktuara. Unë konkretisht do të ndalesha të auditimi i proceseve të prokurimit gjatë vitit 2025.

I kam disa pyetje, pasi mungon raporti i detajuar për këtë zyrë:

Si është vlerësuar mos-përfundimi i disa objekteve industriale investive për më tepër se tre vite. Për shembull, ujësjellësi dhe rezervuarët në Qikatovë, si dhe disa objekte të tjera.

Lidhur me caktimin e kushteve diskriminuese nga Zyra e Prokurimit dhe përshtatjen e kriterëve për kompani të caktuara: ka pasur ankesa nga operatorët ekonomikë të cilët i kanë fituar ato, sa vërejtje keni dhënë dhe sa janë plotësuar ato.

Gjithashtu, sa i përket pranimi të punimeve pa plotësuar kriteret teknike, siç është rasti të shkolla e Komoranit, të parkingu i autobusëve është bërë një gabim që nuk do të bëhej as para 30 viteve. Është rritur pjerrësia e vendparkimit dhe e trotuarit, nesër kur të ketë ngrica, nxënësit rrezikohen të rrëshqasin, sepse vendparkimi është në të njëjtin nivel me trotuarin.

A ka menaxherë profesionalë dhe a ka Zyra e Prokurimit kuadro që t'i përcjellin këto gjëra.

Egzona Tërdevci, raporti është më shumë përshkrim i punës suaj, por me ne si asamblistë nuk janë ndarë informatat nga auditimet që janë bërë. Nuk është qëllimi ta ndajmë me publikun, por t'i dimë për-vetë. Mua më intereson konkretisht auditimi që keni bërë për rishikimin e proceseve të lejet ndërtimore dhe inkasimi i të hyrave vetanake nga prona e dhënë në shfrytëzim. E kuptoj që mund të mos i keni tani informatat konkrete, por nëse mundeni të paktën në vija të trasha, të na tregoni cilat janë gjetjet e këtij auditimi.

Xhavit Drenori, është vërejtja e njëjtë, nuk e di që pikërisht të njëjtat gjëra po i thoshte edhe z. Krasniqi. Ne kemi të drejtë të kemi qasje në raportin e plotë që keni bërë. A kemi të drejtë të bëjmë kërkesë zyrtare si anëtarë të Kuvendit për t'i parë ato të gjetura, rekomandimet tuaja dhe cilat prej tyre janë plotësuar. Ju keni vendosur vija shumë të trasha në këtë raport.

Ky është raport informues, por nuk ka brendi që të mund të debatojmë, ose realisht na lë hapësirë vetëm për t'ju bërë pyetje. Nuk e di deri në ç'masë ligji ju lejon të na jepni këto informata, por siç tha edhe kolegja, çfarë-informacioni komunal mund të jetë i fshehtë apo i mbrojtur me ligj për anëtarët e Kuvendit. Anëtarët e Kuvendit, sikurse edhe Kryetari, zgjidhen direkt nga qytetarët me votë të lirë për t'i përfaqësuar ata.

Auditori i Komunës së Drenasit, Kmer Rama, faleminderit, z. kryesues. Të nderuar asamblastë, meqenëse jemi në fillim të mandatit tuaj, ju uroj të gjithëve punë të mbarë dhe suksese. Njësia e Auditimit të Brendshëm e ka një raport të përgjithshëm përmbledhës. Në vija shumë të trasha, e di dhe c kuptoj këtë, mirëpo meqenëse ligjërisht ne nuk jemi të obliguar të raportojmë para Kuvendit, këtë model ose këtë çështje e kanë ngritur më tepër organizatat e ndryshme ndërkombëtare, të cilat ndajnë fondin e performancës.

Edhe në mesin e tyre kanë vendosur një kriter ose një pikë, se a është diskutuar një raport i auditimit të brendshëm në Kuvend, gjë që është në kundërshtim me të gjitha rregullat ligjore. Ata asamblastë që kanë qenë në legjislaturat e kaluara e dinë, sepse e kemi diskutuar sa herë kemi raportuar për çështje të tilla. Megjithatë, meqenëse është një përbërje më e re e Asamblesë, po e theksoj këtë.

Ne disa herë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, rreth përmbushjes së pyetësorit të performancës, kemi diskutuar vendosjen e kësaj pike si pyetësor dhe e kanë vlerësuar me tri pikë nëse realizohet ose jo. Me ligjet e Kosovës e kemi të ndaluar, sepse ne i raportojmë vetëm Kryetarit dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Për këtë arsye, unë nuk kam mundur ta shtjelloj raportin në detaje të tjera. Ndërsa, sa i përket pyetjes që z. Krasniqi kërkoi, që herëve të tjera të kemi më shumë sqarime, nuk na lejojnë mundësitë ligjore të japim më tepër sqarime sepse jemi auditorë të brendshëm. Kurse raportin e auditimit të jashtëm e paraqesim në Kuvend dhe atë e shihni me pikë e me presje.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën: 12. Raport i përgjithshëm mbi gjendjen faktike lidhur me përmbushjen e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim.

Egzona Tërdevci, të lutem, edhe një herë, në mes të dy seancave të mërcni me çështjen e teknikës, sepse për ne është pak e mundimshme të dalim vazhdimisht në mikrofon kur nuk kemi shumë diskutim. E kemi pranuar këtë raport. Unë e thashë kur fola për pjesën e pronave, është një raport shumë i thatë që nuk i përmban krejt informatat e sakta. Ka shumë gabime, edhe sipërfaqet janë shkruar gabim. Ju lutem që, para se ta sillni raportin në Kuvend, kontrolloni edhe një herë sepse këto diskutime janë publike. Pse nuk na kanë sjellë materiale mbështetëse si kontratat, vlerësimi i ofertave, si dhe do të ishte kartela për secilin.

Unë, si asambliste, vetëm mund t'i besoj një informacioni që na ka përcjellë znj. që e ka përgatitur raportin, por pa asnjë informatë mbështetëse. Si asambliste në mandatin e kaluar pata kërkuar qasje publike në dokumente, kështu që e kam vlerësimin e ofertave dhe i kam pagesat që janë bërë deri në vitin 2023 kur e kam kërkuar dokumentin, por pjesën tjetër nuk na e keni siguruar si asamblastë.

Ne mundemi t'i kërkojmë secili individualisht me kërkesë për qasje në dokumente publike, por ishte dashur që këtij raporti që e keni sjellë sot t'i bashkëngjitej, le të mbetet si vërejtje për herët e tjera. Kur kthehemi individualisht të secili biznes, të biznesi i Ragip Veselit në Komoran, unë e kam vlerësimin e ofertave, kontratën nuk e kam fatkeqësisht. Prona është e destinuar për pompë, aty ka të hapura edhe biznese të tjera, që i bën që kontrata nuk është duke u realizuar siç duhet. Gjithashtu, nëse merret për bazë e kontratës që nëse është vetëm për derivate, për besë aty nuk ka mundësi të ketë të punësuar 50 punëtorë, ashtu si na keni sjellë në raport.

Të prona **IP-Kos** në Drenas, gjithashtu destinimi është për pompë të derivateve (të paktën prej vlerësimit të ofertave, sepse kontratat nuk i kemi). Aty janë edhe shumë biznese të tjera,

aktualisht 6 funksionojnë bashkë me pompën. Është pak paradoksale çfarë qiraje të vogël paguajnë për 6 biznese.

E përmendi kolegu Driton Ajazi, **IP-Kos**, është e vërtetë që i është marrë Valdet Bujupit për mosrealizim të kontratës, që i bie që kontrata nuk është duke u realizuar, sepse **IP-Kos në Arllat** është e dhënë për pompë të derivateve dhe aty është një restorant, pra diçka nuk është në rregull me këto kontrata.

Me ligjin për dhënien e pronave në shfrytëzim, nuk ka të drejtë ai që e merr pronën publike prej komunës ta japë të personat e tretë, pra nuk mundet t'ia dhënë dikujt tjetër me qira. Ne e kemi të paqartë së qysh janë lejuar vazhdimisht këto shkelje. Pronat që nuk i kanë plotësuar kriteret, siç është rasti i **Fer-Petrolit**, është për qendër edukative dhe ajo shfrytëzohet si pompë e derivateve. Po ashtu ka raste që pronat që janë marrë prej Kuvendit Komunal janë zgjeruar. Kur ka dalë inspeksioni t'i shikojë këto prona, siç është rasti i biznesit Thaçi. Ky raport përgjithësisht është i thatë dhe nuk na jep neve informacion se a janë duke u realizuar vërtet këto kontrata apo jo.

Nënkryetari Arben Shala, sa i përket zyrtares në fjalë, nuk e përjashtoj që mund të ketë gabime teknike. Ka qenë kërkesë e imja kjo, që raporti të jetë më i shkurtër, më përmbledhës, në formë narrative dhe tabelare, për t'ua lehtësuar juve të gjithëve punën e për ta parë më lehtë, sepse raportet e përgatitura janë diku afër 500 faqe. Sa i përket kontratave, ju mund t'i gjeni nëpër ueb-faqe.

Driton Ajazi, pajtohem që raporti është shumë i mangët, sepse në raport duhet të detajohen këto çështje. Pikërisht për këtë çështje kisha kërkuar të krijohej një komision që të bëjmë vlerësimin e pronave publike, sepse ajo është një pronë e shenjtë që është dhënë shkel e shko e është duke u shfrytëzuar shkel e shko. Nuk e di me çfarë bazë ligjore është dhënë prona të hekurudha kur të gjithë e dimë që kjo është në procedurë gjyqësore, ka qenë edhe kur e keni dhënë dhe këtu zhvillon biznes një kompani.

Sipas këtij raporti, ajo kompani ka ofertuar për një pompë të derivateve, ndërsa në kuadër të atij biznesi funksionojnë disa biznese: Azteku, Mísini etj. Ne japim për të hapur vende të reja të punës dhe për të funksionuar sipas ligjit, por nuk jemi që në emër kinsë të interesit qytetar të përfitojnë individë, grupe apo biznese të caktuara.

Nënkryetari Arben Shala, i nderuar, ju thoni është dhënë prona shkel e shko, por shkel e shko është dhënë prona 'Gropa e Goleshit' që është në gjykatë. Prona i ka kriteret që i ka përcaktuar; ne nuk jemi për t'ia llogaritur atij biznesi sa përfiton. Biznesi ka interesin e vet, komuna ka interesin e vet. IP-ja në Arllat ka pasur të punësuar 2, eventalisht 3, tani i ka afër 40. Raporti i ka të gjitha pyetjet bazë që besoj se duhet t'i ketë, normalisht që ka nevojë të plotësohet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, kur flisni për pronat që janë dhënë në shfrytëzim 'shkel e shko', është mirë të ceket kjo pronë me numër të parcelës, kohën, datën, si dhe t'i qartësoni të gjitha gjërat që i përkasin asaj prone.

Egzona Tërdevci, mua po më vjen mirë që qenka një raport i detajuar 500-faqësh. Nëse ka mundësi, kryesues, të na e përcillni si link.

Driton Ajazi, nënkryetari po kapet të Goleshi, po unë s'kam parë 'Golesh' në këtë raport, e para. E dyta, unë kërkoja një sqarim: të më shpjegoni cila është baza ligjore dhe a lejohet që personi që e ka në shfrytëzim pronën publike t'ia japë një pale të tretë në shfrytëzim me qira. Këtë e kërkoja unë. Edhe kjo që ka ndodhur, se keni dhënë prona 'shkel e shko', është shumë e vërtetë – dostave tuaj ua keni dhënë. Ne këtu në Drenas jetojmë. Unë do t'i sjell dëshmitë me dokumente në scancën e ardhshme se ajo parcelë është në procedurë gjyqësore."

Xhavit Drenori, nëse ne ia kemi dhënë 'IP-Petrol-it një pronë komunale për të hapur një pompë derivate dhe në të njëjtën pronë komunale ai e ka lëshuar me qira për kompani të tjera, a ka apo s'ka të drejtë. Kjo është përgjigja që po e kërkoj nga ju. Sepse ligjin që e kam lexuar unë, thotë që vetëm ajo palë kontraktuale me komunën e zhvillon biznesin, jo t'ia japë një pale të tretë.

Liman Krasniqi, kisha kërkuar që të bëhet një inspektim për pronat që janë dhënë në shfrytëzim, sepse shumë prej subjekteve juridike që i kanë marrë në shfrytëzim i kanë tejkaluar kufijtë katastrale dhe i kanë uzurpuar rrugët. Ata detyrohen të kthehen në kufijtë katastrale që i kanë në kontratë. Mos t'i përmend me emër, është ai komisioni që i ka vlerësuar.

Egzona Tërdevci, i patëm disa raste që nuk i kanë plotësuar as gjysmën e kriterëve, dy prona i patëm. Cilat janë masat që do të merren tash e tutje për ata që nuk i kanë plotësuar kriteret.

Nënkryetari Arben Shala, po, besoj Kuvendi e ka dhënë pëlqimin dhe Kuvendi duhet të vendosë për to dhe Kuvendi duhet t'i iniciojë.

Zeqir Hasi, nuk është e ndershme që për pronat që i ka dhënë Kuvendi t'ia lini barrën vetëm Kuvendit. Ju po thoni që 'Kuvendi i ka dhënë edhe ne nuk kemi çfarë të bëjmë', por nuk është në rregull t'ia hidhni fajin Kuvendit. Përndryshe, unë propozoj të bëhet një komision prej Kuvendit dhe të dalim në terren t'i shikojmë si komision të gjitha ato prona. Por, do të duhej që komuna të dalë me inspektorat, ta përcjellë gjendjen në terren dhe t'i ndalë punimet nëse janë bërë gabime.

Nënkryetari Arben Shala, të gjithë jeni të lirë të dilni dhe ta inspektoni gjendjen në terren. Në qoftë se keni njohuri për shkelje apo për ndonjë korrupsion, ne e mirëpresim dhe ju falënderojmë. Ndërsa për inspektorët, bëni kërkesë të inspektoratit, del në terren dhe merret me ato çështje.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën 13: Njoftim lidhur me vërshimet në territorin e Komunës së Drenasit.

Xhavit Drenori, Në fillim dua të falënderoj drejtorinë përkatëse për raportin informues mbi menaxhimin e situatës së vërshimeve në komunën tonë. Një falënderim i veçantë shkon për të gjitha institucionet, shërbimet emergjente, zjarrfikësit, policinë, punëtorët komunalë, operatorët ekonomikë dhe qytetarët që ndihmuan, në mënyrë që kjo gjendje e jashtëzakonshme të menaxhohej pa pasoja në jetë njerëzish, por vetëm me dëme materiale.

Të nderuar kolegë, në fillim të janarit komuna jonë u përball me reshje të dendura shiu që shkaktuan rritje të menjëhershme të nivelit të ujërave dhe mbingarkesë të sistemit të kullimit. Si pasojë pati vërshime në disa zona, me dëme në ekonomi familjare, shtëpi banimi, biznese, toka bujqësore, rrugë dhe ura, sidomos përgjatë lumit Drenica.

Siç janë shkruar edhe në Raport, janë realizuar dhjetëra intervenime emergjente, evakuime familjesh, zhblokime kanalesh dhe ndërhyrje në infrastrukturë kritike.

Por këto nuk ishin vetëm fatkeqësi natyrore — ishin sinjale paralajmëruese. Reshje të tjera priten në pranverë. Pra, kemi të bëjmë me një rrezik të parashikueshëm, dhe kur rreziku dihet, mosveprimi bëhet përgjegjësi. Ne si Asamble nuk duhet të jemi vetëm dëshmitarë të dëmeve dhe pastaj shpërndarës të ndihmave. Roli ynë është të kërkojmë politika parandaluese. Prandaj kërkoj nga ekzekutivi komunal veprime konkrete dhe urgjente:

- Inspektim teknik të urave dhe pikave kritike përgjatë lumit Drenica, me raport të detajuar para Asamblesë;
- Pastrimin dhe thellimin e shtratit të lumit në zonat me rrezik;
- Hartimin e një plani komunal për parandalimin e vërshimeve, me masa mbrojtëse dhe protokoll të qartë reagimi;
- Ndarje të mjeteve buxhetore për ndërhyrje parandaluese, sepse parandalimi kushton më pak se riparimi i dëmeve;
- Koordinim me nivelin qendror dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave për mbështetje shtesë.

Po ashtu, pas vërshimeve, së bashku me kolegen Egzona Tërdevci vizituam zjarrfikësit në Drenas. Përveç falënderimit për punën e jashtëzakonshme, u njohuam me mungesat e tyre teknike. Është e domosdoshme që komuna të ndajë buxhet për pajisje konkrete, si: barka për ndërhyrje në ujë, pajisje shpëtimi dhe mbështetje shtesë për punë në kushte rreziku.

Veprimet e tyre të shpejta gjatë vërshimeve e ulin drejtpërdrejt nivelin e dëmeve.

Njëkohësisht, procesi i vlerësimit të dëmeve duhet të jetë i shpejtë, transparent dhe i drejtë për qytetarët e prekur. Çdo shtëpi e përmytur është një familje në stres. Çdo urë e dëmtuar është izolim për fshatra të tëra. Çdo rrugë e prishur është pengesë për ekonominë, shkollën dhe shërbimet.

Prandaj kërkoj që kjo çështje të ndiqet si pikë e veçantë, me raportim konkret nga ekzekutivi brenda një afati të shkurtër. Me kolegen Egzona Tërdevci vizituam lagjen Ademi në Dritan dhe pamë që një pjesë e asfaltit kishte dalë komplet andej, që edhe si situatë ishte pak interesante. Kemi analizuar me kolegen dhe kemi shikuar edhe disa ura pak më poshtë, në komunat fqinje si në Obiliq e Fushë-Kosovë dhe pamë që mungesa e një mburoje me beton të pjesët përbërëse të urës, krahët e urës... sepse urat si ura nuk kanë lëvizur, por krahët e urës, në qoftë se nuk betonohen ashtu siç duhet, dëmi bëhet edhe më i madh pastaj.

Prandaj, për çfarë ka ndodhur dhe nuk po dua të akuzoj askënd, por të mos na ndodhë të bëhet edhe nesër një dëm i madh. Qytetarët nuk presin fjalë nga ne. Presin siguri. Faleminderit.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda, kemi dalë me një ekip dhe i kemi monitoruar të gjitha vendet e prekura nga vërshimet, i kemi listuar të gjitha në një raport dhe i kemi dërguar në Ministri, pasi Komuna e Drenasit nuk ka fond emergjent.

Nënkryetari Arben Shala, sa i përket pjesës së organizimit, Komuna e Drenasit i ka dy dokumente strategjike të realizuara. Planin për Reagim Emergjent dhe Planin e Vlerësimit të

Rrezikut. Komuna e Drenasit ka bërë kërkesë të AME-ja për rritjen e numrit të zjarrfikësve, sepse Komuna e Drenasit ka vetëm 3 zjarrfikës, por në rast të fatkeqësive natyrore është obligim i secilit të kontribuojë dhe të solidarizohet kur kemi fatkeqësi natyrore.

Driton Ajazi, situata me vërshimet ka qenë e ndjeshme dhe na ka prekur të gjithëve, por fatkeqësisht këto vërshime po përsëriten dhe fatkeqësia më e madhe është që përgjegjësit nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për evitimin e tyre.

Këtë e them me bindje dhe përgjegjësi morale. Nëse do të kishim investuar në rregullimin e shtrimit të lumit dhe kolektorëve që janë për përcjelljen e ujërave atmosferikë, nuk do të kishim ardhur deri të kjo gjendje.

Unë mendoj që kjo kërkon një trajtim dhe një përgjegjësi përtej asaj të dalësh me mbathur disa çizme e të bësh filma për votë të qytetarëve, sepse kur inxhinieri i thoshte kryetarit. Komorani është shumë ulët, e merr ujë, kryetari i thoshte 'mos të intereson ty. Këto janë shqetësimet e mia si asamblist. Rregullohen këto gjëra, vetëm duhet konsultuar me profesionistë, ekspertë të fushave përkatëse. Ne duhet të marrim veprime konkrete institucionale sipas përgjegjësisë që përfaqësojmë – ne si asamblistë dhe ju si ekzekutiv.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, theksoi që edhe vullneti, jo vetëm i juaji, por edhe i një pjese të madhe të kolegëve, së bashku me mua, ka munguar për t'u dalë në ndihmë qytetarëve, për të bërë një gjest sa do të vogël human e për t'u solidarizuar me familjet e prekura – për pos Egzonës dhe Xhavitit edhe një pjese të vogël të asamblistëve.

Nënkryetari Arben Shala, sa i përket thellimit të lumit, e kemi rregulluar shtratin. Dikush nga ju ka thënë që keni bërë krim ekologjik, se është dëmtuar flora dhe fauna e Komunës së Drenasit. As ne e as kryetari nuk kemi dalë në terren për vota edhe ju keni mundur t'i merrni çizmet e të dilni të kontribuoni sado pak. Sa i përket inxhinierit në Komoran, kryetari ka kërkuar të respektohet kontrata që është nënshkruar. Sa u përket vërshimeve, ajo pjesë nuk është vërshuar në Komoran ku është bërë videoja. Kryetari nuk e jep asnjë tender, është Zyra e Prokurimit që i jep tenderët.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda, faleminderit për vlerësimin, por të jemi të qartë para qytetarëve kur flasim për vlerësimin, nëse e përcillni faqen zyrtare të komunës, më 4 tetor, si Drejtori e Shërbimeve Publike, për herë të dytë e kemi bërë pastrimin e të gjitha kanaleve kulluese. E kemi operatorin që, sa herë e shohim se kemi nevojë për hapjen e tyre, ne e bëjmë, pikërisht të lokalet e reja. Sa i përket çizmeve, po, unë kam qenë ai që i kam mbajtur 15 orë mbathur.

Egzona Tërdevei, faleminderit shumë kryesues. Me qëllim të kërkoja fjalën në periudhën kur fole ti. Nëse kemi raste të vërshimeve herë e të tjera, iniciativa duhet të vijë nga ju, i nderuar kryesues, për të na organizuar ne. Uroj që të mos kemi më asnjëherë vërshime. Të përmirësojmë punën për herët e tjera, sepse ajo që ka kaluar nuk mund të kthet më. Po dua ta përmend një rast specifik, është çështja e lokaleve të reja të qendra tregtare. Pretendimi i tyre është që është mbyllur gypi i kanalit atmosferik qëllimisht.

Nuk po them që është i vërtetë, apo që nuk është intervenuar me kohë që të dëmtohet prona e pastaj t'i jepet dikujt tjetër. Unë i kam thënë edhe kryetarit se mënyra më e mirë për të dëshmuar

që s'ka qenë qëllimi për t'ua mbyllur qëllimisht, është të rregullohet infrastruktura përcjellëse për të lokalet e reja. Ne e dimë që ai objekt ose nuk është punuar mirë, ose është jashtë standardeve teknike – më mirë mund të na flasin ekspertët e fushës – por që është vërshtuar gjithmonë, të gjithë jemi dëshmitarë, por jo të këtij niveli kaq të madh. Unë e vlerësoj punën që keni bërë si ekzekutiv në menaxhimin e situatës, besoj së keni mundur të bëni hapa më të mëdhenj para vërshimeve, por megjithatë reagimi ka qenë korrekt, sidomos prej profës Nexhmedin Gruda. Ai, në kohën kur e kam pasur arsimtar në Gllobar, me një Pentium 4, mësuesi Nexh na ka mësuar t'i përdorim Excel-in dhe Word-in dhe kur kemi shkuar në shkollë të mesme, kemi qenë të dalluar si nxënës.

Mos të bëhemi toksikë duke përmendur vetëm shembujt e këqij, duhet t'ia përmendim edhe shembujt e mirë. Kisha kërkuar nga ju, drejtor, të di a ka ndonjë plan preventiv për tash e tutje për vërshime, me theks të veçantë për qendrën tregtare që na e kanë adresuar si shqetësim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e nderuar, në kohën e vërshimeve edhe unë kam pasur telashe me biznesin tim. Unë nuk kursej asgjë nga vetja, sepse shpeshherë me një gjë shumë të vogël mundesh të tregosh se çfarë je dhe çfarë mundesh të bësh.

Driton Ajazi, e përmendi edhe znj. Tërdevci, nuk e kontestoj profesionalizmin e drejtorit Gruda, përkundrazi, e thashë me qëllimin e mirë që ka qenë i angazhuar. Çështja e çizmeve nuk ka qenë për ty, por për zotërinë që iku dhe nuk pati argumente të ballafaqohesh, as për çështje të vërshimeve e as të pronave. Unë shpreh mirënjohjen time të thellë për secilin që është angazhuar dhe bashkëndej me secilin që i ka ndodhur, por ne po kërkojmë përgjegjësi institucionale këtu si legjislativ, që duhet të ndërmarrë masa dhe ta vërë si prioritet këtë çështje të vërshimeve. Sepse më i rëndësishëm ka qenë cvitimi i vërshimeve sesa ndërrimi i kockave të sheshit – kjo është ajo që po kërkoj unë.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda, ne, me kapacitetet tona si komunë, jemi munduar t'i bëjmë të gjitha detyrat tona, por ne nuk kemi fond emergjent. Domethënë, nuk kemi mjete, por me mirëkuptim po mundohemi me operatorët ekonomikë, të cilët i falënderoj shumë, si dhe disa asamblastë në mesin tuaj që kanë shprehur gatishmëri për të na ndihmuar.

Xhavit Drenori, megjithatë, dy përgjigje nuk i morëm. E para, veprimet tuaja tash, jo dje, po sot. Tash pas vërshimeve të lokalet e reja, çfarë keni në plan të bëni. Kur të bjerë shi në fillim të pranverës, çfarë ka për të ndodhur.

Ato biznese që janë dëmtuar shumë, a janë të sigurta ta kthejnë mallin në vend të vet, apo duhet ta vendosin në blloka ende. A keni bërë ndonjë veprim konkret të cilin mund t'ua prezantoni atyre bizneseve, ose përmes nesh, ose përmes kamerave këtu.

Dhe e dyta, ju e keni përmendur edhe në raport që duhet një barkë. Thoni që nuk kemi fond emergjent, mirëpo ne mundemi të bëjmë një rishikim të buxhetit dhe mundemi t'i kthehemi e të punojmë. Ju si ekzekutiv i keni këto detyra, propozimet për plotësim-ndryshim dhe për ridestitim të buxhetit bëhet gjithmonë prej ekzekutivit. Sepse, me të vërtetë, zjarrfikësit janë duke punuar me minimumin e kapaciteteve. Madje, nëse merret për bazë numri i banorëve me atë të makinerisë dhe të infrastrukturës teknike që kanë ata njerëz, është jashtëzakonisht e rëndë; është t'u thuash qytetarëve. Dhashtë Zoti e nuk na ndodh asgjë.

Edon Nishori, deshta ta falënderoj drejtorin për aktivitetin e madh që ka bërë gjatë këtyre vërshimeve dhe të ndalem të një pjesë e asamblistëve, që nuk janë bërë si shumica që kemi raportuar ditë e natë, secili nëpër lagjet ku kemi pasur raste. Ne e kemi pasur detyrë të raportojmë të drejtori. Kur t'i, në një gjendje të jashtëzakonshme, mundohesh të përfitosh politikisht, atëherë për mua je shumë i pavlerë.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda, në çdo herë jemi në monitorim të situatës dhe i kemi hapur të gjitha kanalet kulluese, duke përfshirë edhe ato të lokaliteteve. I kemi në dispozicion edhe pompën, por këto kapacitete i kanë zjarrfikësit. Në rast se e kemi përcjellë edhe buxhetin e kaluar, kemi pasur shkurtime buxhetore, ne kemi kërkuar një autocisternë për zjarrfikësit, por nuk është aprovuar sepse na i ka marrë mjetet përmbaruesi. Ne jemi duke i bërë planifikimet për të ardhmen. Buxheti nuk është aprovuar prej qeverisë ende, nuk mund të bëhet rishikim buxhetor kur nuk është aprovuar buxheti. Sa i përket angazhimit komunal, qoftë prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, stafit të drejtorisë dhe drejtorive të tjera, të jeni të sigurt se jemi duke e shqyrtuar dhe duke paraparë që mos të na ndodhin vërshime të këtyre përmasave.

Liman Krasniqi, ju falënderoj për punën që keni bërë gjatë vërshimeve. Mirëpo, sa i përket qendrës tregtare, unë kisha propozuar së bashku me ekzekutivin është t'i kontrollojë kanalet: atë që përcjell ujërat atmosferikë — a është funksional apo nuk është — dhe kanalën që përcjell ujërat fekale.

Ndërsa sa i përket largimit të ujit, unë kisha propozuar së janë drejtoritë përkatëse, si Drejtoria e Infrastrukturës që i ka inxhinierët e hidros, të cilët kanë mundësi ta matin vëllimin e ujit që është grumbulluar — që e rrezikon objektin, për të bërë një elaborat për mënyrën e largimit të atij uji. Gjithashtu, të kërkohet përkrahje financiare prej atyre bizneseve, sepse ato i kanë prona private, nuk i kanë në shfrytëzim që ta marrë obligim komuna.

dhe me kërkuar përkrahje financiare prej atyre bizneseve sepse ato i kanë prona private, nuk i kanë në shfrytëzim që për me marr obligim komuna.

Domethënë, është obligim i ekzekutivit të komunës tonë t'u hartojë një elaborat dhe një kosto se sa ju kushton, ndërsa dy kanalet që i përmenda janë obligim i ekzekutivit t'i sjellë në gjendje funksionale.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e 14-të:
Të ndryshme.

Egzona Tërdevci, ngriti një çështje që i është përcjellë nga prindërit e nxënësve të shkollës "Rasim Kiqini". Sipas informatës, që nga fillimi i gjysmëvjetorit të dytë nuk ka ngrohje dhe nxënësit po mbajnë mësim në kushte të vështira për shkak të ftohtit.

Drejtoresha e Administratës, Laureta Thaqi, u përgjigj se të gjitha shkollat janë të pajisura me pelet, duke përfshirë edhe objektin e komunës. Sipas saj, mund të jetë ndonjë defekt në sistemin e ngrohjes qendrore të shkollës.

Xhavit Drenori, është çështja me mbeturinat. Mos me shkuar tri javë kompania, e cila paguhet për t'ua marrë mbeturinat njerëzve, ky është një skandal. Nuk më intereson çka është lëshëveprimtaria e ekzekutivit tonë ose e jona, ne e kemi për detyrë me e ngritë si çështje. Duhet ekzekutivi dhe drejtoria përkatëse me dalë dhe me thënë: "Po, ne e kemi ngritë këtë", sepse kjo po i prek qytetarët tanë. Ata po paguajnë dhe shërbim nuk po marrin. Është një çështje shumë e ndjeshme që ne duhet me i bërë zgjidhje. Ju lutem, mos lini gur pa lëvizur sepse jam konsultuar me ekspertë për këtë çështje.

Tani është mot i ftohtë, por në momentin që nxehet moti dhe qëndrojnë ato mbeturina ashtu, munden edhe sëmundje të ndryshme me u përhapur. Fajtorët jemi ne që kemi menaxhuar keq, secili prej nesh që kemi marrë përgjegjësi para qytetarëve, sepse ata po thonë: "Ne ju kemi zgjedhur për me na bërë zgjidhje".

Prandaj, të lutem na trego veprimet që jeni duke i bërë, duhet me u gjetur një fajtor sepse diçka nuk po funksionon.

Mërgim Pirraku, edhe pse nuk dua me marrë barrën me iu përgjigjur pyetjes së Drenorit (sepse qytetarët mendojnë se jam drejtor në kompani), unë jam një anëtar i komisionit për kompaninë nga Kuvendi. Ne kemi mbajtur mbledhje; edhe pse me ligj është me u mbajtur një herë në gjathtë muaj, ne kemi mbajtur çdo tre muaj në kompani dhe kemi bërë raportime këtu. Më herët tha zotëri Shala që s'keni bërë raportime, por unë nuk e di që s'kemi bërë ndonjëherë raportime këtu. Ka ardhur drejtori Kastriot Berisha nga kompania në këtë Kuvend dhe kemi ngritur çështje. Çdo javë e kontaktoj në telefon dhe bisedojmë për këtë çështje, po këto janë probleme të grumbulluara që 20 vite.

Kompania ka pasur një kërkesë që nuk ia ka përkrahur komuna: ka kërkuar me shtrenjtuar çmimin e mbeturinave sepse, në bazë të këtyre fondeve që i grumbullojnë, nuk mjaftojnë me i mbuluar të gjitha shpenzimet, dhe ne nuk e kemi përkrahur kompaninë. Kështu që unë po kërkoj nga zotëri Shala, që tani është kryetar i komisionit, me na thirrur dhe me shikuar; tek e fundit, nëse është nevoja, me mbajtur mbledhje çdo ditë dhe me e zgjidhur këtë problem. Një pyetje tjetër kam për Petrit Gashin. Banorët e fshatit Sankoc në Golesh e kanë bërë një kërkesë për me mbyllë një poligon të ushtrisë në këtë fshat. Çfarë masash planifikoni me marrë në vazhdim dhe deri ku ka arritur çështja?

Driton Ajazi, një shqetësim që e pata, një pjesë të tij e përmendi edhe zotëri Xhavit. Po ju drejtohem juve, zotëri Gruda, që jeni përgjegjës për monitorimin e kompanive publike që operojnë në Drenas, siç janë KRM "Pastrimi" dhe KRU "Pristina". E përmendi Xhavit deponinë, por jo edhe bërëllokun që nga një muaj nuk shkojnë me e marrë. Shqetësimi më i madh është degradimi i ambientit sepse po shpërndahen gjithandej fshatit.

Ju si komunë jeni përgjegjës për monitorimin e këtyre kompanive dhe me kërkuar llogari nga KRM "Pastrimi". Sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, sa herë që kemi reshje, qytetarët e komunës së Drenasit mbesin me javë të tëra pa ujë. Kjo është skandaloze; jemi në shkullin 21, në vitin 2026, kjo është papërgjegjësi institucionale.

Artian Krasniqi, një shqetësim për rrugën "Mentor Ibriqi" në Komoran. Më herët në këtë rrugë kanë ekzistuar pengesa për ngadalësimin e trafikut, të cilat janë larguar së fundmi. Sipas qytetarëve, rreziku nga shpejtësia e automjeteve është i lartë. Kërkoj nga drejtoria përkatëse që

urgjentisht të vlerësojë situatën në terren dhe, nëse konstatohet rrezik, të rikthehen pengesat ose të vendosen masa të reja të sigurisë rrugore.

Edon Nishori, deshta me u ndal te një problem me mbeturinat që na prek të gjithëve. Unë e di që në takime kryetari e ka përmendur që problemin regjional me mund me e bërë komunal. Nëse nuk gaboj, në Skenderaj edhe në Vushtrri është një rast i tillë, "Eko Natyra", që e kanë kthyer në problem komunal, në mënyrë që edhe ne si asamble me i shtyrë përpara. Në këtë aspekt, me qenë në shërbim të plotë të komunës dhe të qytetarëve, desha me ditë: A mundemi me e hequr atë regjional e me e kthyer në komunal. Në mënyrë që edhe merita, edhe kritika, edhe përgjegjësia me qenë bashkërisht e komunës – edhe lëvdatat, edhe kërkesat, edhe ankesat. Po ashtu, dje në Komoran treguan që kompania "Fer Petrol", kur ka punuar, e ka dëmtuar gypin e ujës-jellësit dhe kanë mbetur dy-tri lagje pa kyçje. A mundet me u kërkuar llogari prej kompanisë intervenuese, në mënyrë që me ua mundësuar edhe atyre lagjeve me u kyçur në ujës-jellës si të gjithë të tjerët?

Mërgim Pirraku, e kam një përgjigje në pyetjen e Edonit. Në mandatin e kaluar e kemi bërë kërkesën që kompania nga regjionale me u kthyer në lokale dhe e kemi votuar këtu, mirëpo rekomandimet e Ministrisë së Ambientit dhe GIZ-it gjerman (që e ka financuar gjatë gjithë kohës kompaninë) kanë qenë kundër; mos me kaluar nga regjionale në lokale.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda: Zotëri Drenori, ne i marrim raportet çdo ditë prej kompanisë dhe e shohim që nuk po kryhen shërbimet siç duhet. Pavarësisht që pothuajse të gjitha asetet që janë në shërbim janë asete të komunës, kemi marrë hapa konkretë. Në javën e kaluar i kam përcjellë kryeshefit të kompanisë email zyrtar për këto ngecje në terren, por ata kanë probleme me financat që i kanë trashëguar. Zotëri Krasniqi, sa i përket pengesave, administratori i Komoranit 2 e ka bërë kërkesën për largimin e tyre. Inspektorati i ka larguar pothuajse në çdo lagje me kërkesën e njësisë së zjarrfikësve dhe të ndihmës së shpejtë, sepse kur kanë raste emergjente, ato po ju shkaktojnë probleme. Përjashtoj këtu pengesat afër shkollave.

Pasi nuk pati pyetje dhe diskutime të tjera, kryesuesi i Kuvendit Komunal, **Burim Bujupi**, e shpalli mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 14:35.

Proccsmbajtëse:

Fakete Hoti

Lekturoi

Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i kuvendit komunal Drenas

Burim Bujupi